



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV
TIRANE

NR.13530/10666/6073/1706/213 AKTI

NR.250 VENDIMI

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Apelit Administrativ, ne trup gjykues te perbere nga:

Blerona Hasa-----Kryesucse;
Arjan Qafa-----Anctar;
Fjoralba Prifti-----Anctare,

asistuar nga sekretare gjyqesore Sonja Traja, sot me date 31.01.2019, ora 09.55, shqyrtoi ne dhome keshillimi, ceshtjen administrative Nr.13530/10666/6073/1706/213 Akti Dt.21.12.2015, me:

PADITese: [REDACTED]

E PADITUR: Drejtoria e Spitalit Rajonal, Vlore.

NDERHYRESA DYTesor: - [REDACTED]
- [REDACTED]

PERSON I TRETET: Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

OBJEKTI: Shperblim demi moral dhe material dhe demi i munguar.

BAZA LIGJORE: Nenet 32-154 e vijues te K.Pr.Civile dhe Nenet 625, 608, 640 e vijues te Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, me Vendimin Nr.714 Dt.10.04.2015, ka vendosur:

“- Rrezimin e padise se paditeses [REDACTED]
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se ketij vendimi”.

Paditesja dhe nderhyresit dytesore, kane ushtruar te drejten e ankimit ne Gjykatën e Apelit Administrativ, duke kerkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kerkespadise, per keto shkaqe:

"Vendimi civil i Gjykates se Shkalles se Pare Vlore eshte rezultat i zbatimit te keq te ligjit procedural civil dhe atij material ne vleresimin e akteve dhe provave shkresore, te cilat ju paraqiten per shqyrtim gjykates se faktit. Nga aktet qe ju nenshtruan shqyrtimit gjyqesor, rezultoi sipas arsyetimit te gjykates, si me poshte:

Pala paditesja [REDACTED] ka qene e punesuar prane pales se paditur Spitali Rajonal Vlore qe prej dt.07.06.2001 me detyre "Laborante kimiste". Pas nje periudhe te shkurter prej kater muaj ajo ka vijuar me detyren e "Laborantes kimike" prane Poliklinikes se qytetit Vlore. Paditesja gjate periudhes se punes nuk rezulton te kete marre ndonje verejtje apo mase tjeter per mospermbushje te detyrimeve qe rrjedhin nga kontrata e punes. Ne nentor te vitit 2012, paditesja eshte pajisur me raport mjekesor per paafesi pune per nje periudhe 6 mujore. KMCAP me vendimin nr.380, dt.07.06.2013 e ka klasifikuar si person me invaliditet te pjesshem per periudhen 13.05.2013 - 30.04.2014. Pas perfundimit te raportit 6 mujor, ne dt.30.05.2013 paditesja eshte paraqitur ne detyre. Nga administrata e poliklinikes i eshte ofruar mundesia e perfitimit te lejes se zakonshme per periudhen 13.05.2013 - 13.06.2013.

Me shkresen nr.1380, dt.06.05.2013 nga ana e drejtuesit te Spitalit Rajonal eshte njoftuar: "Nderprerja e marredhenieve financiare ne dt.07.05.2013 te znj. [REDACTED], ne cilesine e laborantes, pasi nuk ka arsimin e mjaftueshem per kete detyre si laborante. Znj. [REDACTED] ka mbaruar shkollen e mesme industriale dhe nje kualifikim 3 mujor per laborante". Po keshtu me shkresen nr.1539 prot, dt.31.05.2013 drejtuesi i Spitalit Rajonal Vlore ka urdheruar: "...Lirimin nga detyra te znj. [REDACTED] per arsye: a- Mosparaqitje ne vendin e punes qe nga data 13.05.2013 e deri me sot per arsye te pajustificuara; b- Per mosperputhje te arsimit qe kerkon vend i punes me arsimin perkates te zonjes".

Pervec demit ekonomik qe i eshte shkaktuar apleueses ne kete largim nga puna i eshte shkaktuar edhe dem moral e pasuror, i cili ka sjelle nje gjendje shendetesore te keqe te apelueses Tiftiri Rrokaj.

Gjykata mori nje vendim pa pranine e pales se paditur, nuk u paraqit asnjehere per te argumentuar motivacionin e largimit nga puna te paditeses, gje e cila ngre dyshime per nje vendim jo te drejte te gjykates. Gjykata theksoi se paditesja nuk paraqiti asnje prove per te provuar demin jopasuror te shkaktuar (shendetesor, cenim te personalitetit dhe te nderit).

Nga akt ekspertimi i bere rezultoi se, paditesja shfaq simptoma te depresionit dhe ankthit qe jane zhvilluar ne kohën qe eshte shkarkuar nga detyra, gjendje e cila ka ndikuar ne realizimin e potencialit te vet njerezor, profesional, qe ka ndikuar ne mospunesimin e saj. Nuk rezultoi qe eksperti i ishte referuar ndonje raporti mjekesor, pershkrimi te meparshem psikologjik, klinik apo trajtimit me medikamente.

Mendojme se gjykata e ka vleresuar ne menyre e gabuar kete akt ekspertimi te bere nga psikologu. Gjykata nuk e ka permendur ne arsyetimin e saj fare ekspertin vleresues te demeve shendetesore, i cili ne raportin e tij te paraqitur para kesaj gjykate, ka percaktuar ne menyre te qarte dhe te detajuar gjendjen shendetesore te paditeses [REDACTED] pas faktit te paligjshem te shkaktuar me faj nga i padituri Spitali Rajonal Vlore ne dem te saj, duke bere edhe vleresimin edhe per shumen e kerkuar.

Gjithashtu mendojme se gjykata e ka trajtuar padine e bere nga paditesja si nje padi ne lidhje me marredheniet e punes dhe jo si padi diskriminimi te ngritur nga paditesja sipas ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi".

Gjykata e Apelit Vlore, me Vendimin Nr.1317 Dt.19.11.2015, ka vendosur:

“Shpalljen e moskompetences se Gjykates se Apelit Vlore per gjykimin e ceshtjes civile me Nr.2158 Regjistri Themeltar, dt.23.06.2015 dhe dergimin e akteve per kompetence Gjykates Administrative te Apelit Tirane”.

GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV

pasi degjoi relatimin e ceshtjes nga gjyqtari kryesues, referuar akteve bashkengjitur dosjes Nr.714 Dt.10.04.2015:

VEREN

Nga aktet bashkengjitur dosjes qe i perket vendimit objekt ankimi rezulton se, paditesja [REDAKTUAR] ka qene ne maredhenie punc me Spitalin Rajonal Vlore, deri ne momentin e disponimit nga Drejtori i Spitalit Rajonal Vlore, te Urdherave Nr.1380 prot. Dt.06.05.2013 dhe Nr.1539 prot. Dt.31.05.2013, qe konsistonin ne zgjidhjen e kontrates se punes me paditesen.

Konflikti per shkak te zgjidhjes se menjehereshme e te pajustificuar te kontrates mes ketyre paleve, rezulton te jete shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore e cila ka disponuar ne perfundim, Vendimin Nr.2264 Dt.14.10.2013, qe konsiston ne pranimin e kerkespadise se paditeses [REDAKTUAR] dhe ngarkimin e te paditurit Spitali Rajonal Vlore, me detyrimin e pagimit ne favor te saj, te 23 pagave mujore demshperblim, ne baze te dispozitave te Kodit te Punes.

Ky vendim rezulton te kete marre forme te prere me date 19.11.2013, pa u ankimuar nga palet ndergjyqese.

Njeheresh me kerkespadine, paditesja [REDAKTUAR] rezulton t'i kete parashtruar Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ankesen Nr.32 Regjistri Dt.10.07.2013 dhe ky i fundit, ne perfundim te shqyrtimit rezulton te kete disponuar Vendimin Nr.98 Dt.09.10.2013, qe konsiston ne konstatimin e diskriminimit te drejtperdrejte te ankuses, nga ana e te paditurit Spitali Rajonal Vlore, per shkak te gjendjes shendetesore ne fushen e punesimit, duke rekomanduar njeheresh rikthimin e saj ne vendin e meparshem te punes.

Gjithashtu, Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi rezulton te kete disponuar edhe Vendimin Nr.56 Dt.17.04.2014, qe konsiston ne ndeshkimin e Spitalit Rajonal Vlore, me 60.000 leke gjobe, per shkak te moszbatimit te rekomandimeve te tij (vendim i anuluar me Vendimin Nr.5122 Dt.25.09.2014 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane).

Paditesja [REDAKTUAR] e ka bere ceshtjen konflikt gjyqesor, duke kerkuar nepermjet kerkespadise se saj, shperblimin e demit moral e material, shkaktuar prej largimit te padrejte nga puna.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, paditesja dhe nderhyresit dytesore kane pretenduar se:

“Siç rezulton e provuar dhe vertetuar me librezën e saj të punës në hetimin dhe gjykimin e kësaj çështje, paditesja [REDAKTUAR] ka punuar pranë Drejtorisë Rajonale Shëndetësore Vlorë, prej një periudhe kohe 13 vitesh si laborante. Në të gjithë periudhën kohore të marrëdhënieve të punës me të paditurin, ajo është shquar për korrektesë dhe profesionalizëm në ushtrimin e detyrës së saj, duke mos qenë asnjehere të vetme objekt i veprimeve apo të terheqjes së vëmendjes nga eprorët e saj.

Me shkresën nr.1380, dt.06.05.2013, paditesja [REDAKTUAR] është njoftuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë, për nderprerjen e marrëdhënieve financiare, pasi sipas saj ajo nuk kishte arsimin e mjaftueshëm për të kryer detyrën si laborante dhe në vijim me shkresën nr.1539, dt.31.05.2013 paditesja njoftohet nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë për nderprerjen e marrëdhënieve financiare me arsyen se paditesja [REDAKTUAR] nuk është paraqitur në vendin e punës dhe është në mosperputhje të arsimit që kërkon vendin e punës.

Në lidhje me pretendimin se ajo nuk ka arsimin e mjaftueshëm, u provua në gjykim se paditesja ka kryer arsimin e mesëm industrial në specialitetin “Kimi Inorganike” dhe një sere kualifikimesh të cilat kërkonte pozicionin e saj të punës.

Gjate shqyrtimit gjyqësor u provua se, nga periudha 27.11.2012 deri më 13.05.2013, paditesja [REDAKTUAR] ka qenë me raport mjekësor nga Q.S.U “Nënë Tereza” Tiranë dhe Komisioni Mjeko Ligjor Vlorë. Nga data 13.05.2013 deri në 13.06.2013 (periudhë brenda së ciles është vendosur edhe nderprerja e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare ndërmjet paditeses dhe të paditurit D.R.SH Vlorë), ajo ka qenë me leje të zakonshme. Po ashtu rezulton e provuar se me datë 07.06.2013, K.M.C.A.P Vlorë e ka shpallur paditesen [REDAKTUAR] invalide të pjesshme, duke percaktuar edhe kohën e saj të punës që do të ishte 8 ore pune të përshtatshme.

Ndërsa të dy këto shkresa për nderprerjen e marrëdhënieve të punës dhe ato financiare të paditeses me të paditurin, vlerësojmë se kanë qenë të paligjshme, një veprim tjetër i paligjshëm i të paditurit ndaj paditeses ka qenë fakti se i padituri gjatë kohës që paditesja [REDAKTUAR] ka qenë e hospitalizuar në Q.S.U Tiranë, nuk e ka trajtuar atë me ndihmë ekonomike, e cila jepet nga fondi i veçantë në rastet e veçantë kur punonjësit janë me sëmundje të rënda, si në rastin konkret atë të paditeses [REDAKTUAR] e cila ka bërë nderhyrje kirurgjikale në zëmër, në dallim me punonjësit të tjerë të D.R.SH Vlorë që e kanë përfituar atë ndihmë.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.2264, dt.14.10.2013 ka vendosur paligjshmerinë e këtyre veprimeve të të paditurit Spitalit Rajonal Vlorë për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me paditesen [REDAKTUAR]. Si rezultat i këtij veprimi të paligjshëm i të paditurit ndaj paditeses, kjo e fundit është drejtuar edhe institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili pas një sere veprimesh ligjore dhe hetimit të çështjes nga ana e tij të veprimeve të kundraligjshme të kryera nga i padituri ndaj paditeses [REDAKTUAR] komision i cili me vendimin nr.98, dt.09.10.2013, ka vendosur: “Konstatimin e diskriminimit të drejtperdrejtë të znj. [REDAKTUAR] nga i padituri Spitali Rajonal Vlorë dhe me vendimin nr.56 dt.17.04.2014 po ky komision ka vendosur të gjobisë atë me 60.000 leke, për shkak të moszbatimit të rekomandimeve të komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Si rezultat i këtyre veprimeve të paligjshme ndaj saj, tek paditesja [REDAKTUAR] janë shfaqur probleme serioze të shëndetit, ajo ka bërë vizita mjekësore në Vlorë dhe me pas është shtruar në Q.S.U Tiranë, ku pas ekzaminimeve mjekësore ndaj saj, ka bërë nderhyrje kirurgjikale në zëmër të cilat vertetohet mjekimet dhe terapi të saj në vazhdimësi. I padituri Spitalit Rajonal Vlorë, me shkresën nr.1380, dt.06.05.2013 dhe me shkresën nr.1539,

dt.31.05.2013, ne menyre te kundraligjshme, duke vene ne diskutim seriozitetin e institucionit dhe te tij personal, ka bere diskriminim ne menyren me te papergjegjeshme e arrogante ndaj shendetit dhe personalitetit te paditeses Tiftiri Rrokaj, ne shkelje te plote me ligjet ne fuqi.

Ne nenin 1, te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" percaktohet qarte se kush jane shkaqet te cilat mund te vendosin nje subjekt ne pozita diskriminuese. Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit te barazise ne lidhje me gjinine, racen, ngjyren, etnine, gjuhen, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqerore, shtetezanine, perkatesine prinderore, pergjegjesine prinderore, moshen, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shendetesore, predispozicione gjenetike, aftesine e kufizuar, perkatesine ne nje grup te vecante ose me çdo shkak tjetër. Edhe ne nenin 3.1 te po ketij ligji, perkufizohet fenomeni i diskriminimit; "Diskriminim eshte çdo dallim, perjashtim, kufizim apo preference, bazuar ne cilindo shkak te permendur ne nenin 1 te ketij ligji, qe ka si qellim apo pasoje pengesen apo berjen e pamundur te ushtrimit ne te njejten menyre me te tjeret, te te drejtave e lirive themelore te njohura me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, me aktet nderkombetare te ratifikuara nga R.Shqiperise, si dhe me ligjet ne fuqi".

Pra shkelja e parimit baze te barazise se shtetasve, eshte kushti i vetem dhe i mjaftueshem per te patur diskriminim pavaresisht formes ne te cilat mund te shfaqet shkakun abuziv. Per sa me siper, ne mbeshtetje te ketyre neneve te ketij ligji, paditesja eshte diskriminuar per shkakun se i eshte kufizuar profesioni, profesion per te cilin ajo eshte arsimuar dhe i eshte nenshtruar te gjithë kualifikimeve perkatese, duke i nderprere asaj marredheniet e punes. Rasti i znj. [REDAKTUAR] pasqyrohet plotesisht ne neni 3.2 te ligjit te sipercituar i cili percakton; "Diskriminimi i drejtperdrejte eshte ajo forme diskriminimi qe ndodh kur nje person apo grup personash trajtohen ne menyre me pak te favorshme se sa nje person tjetër, apo nje grup personash ne nje shtate te njejte a te ngjashme, bazuar ne cilindo shkak te permendur ne nenin 1 te ketij ligji". Te gjithë keto veprime ndaj paditeses [REDAKTUAR] klasifikohen si "viktimizim", ne mbeshtetje te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi". Pra eshte shume e qarte se ngjarja ne fjale eshte nje rast i paster diskriminimi dhe viktimizimi.

Edhe Konventa Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut, proklamoi qarte dhe sakte ne nenin 14 te saj ku percaktohet se; "Gezimi i te drejtave dhe lirive te njeriut te parshikuara ne kete konvente, duhet te sigurohet pa asnje dallim te bazuar ne shkaqe te tilla si raca, ngjyra, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombetare ose shoqerore, perkatesia ne nje minoritet kombetar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër", ndersa ne nenin 1 kesaj konvente thuhet; "Çdokush te cilit i jane shkelur te drejtat dhe lirate e percaktuara ne kete konvente, ka te drejten e nje zgjidhje efektive perpara nje organi kombetar pavaresisht se shkelja kryhet nga persona qe veprojne ne permbushje te funksioneve te tyre zyrtare".

Duke u mbeshtetur ne nenin 608 e vijues te K.Civil, paditesja me ane te kerkese padise ka parashtruar kerkime duke paraqitur provat perkatese per detyrimin e te paditurit qe t'u demshperbleje per te githe demet pasurore dhe jo pasurore dhe te tjera te nevojshme e te arsyeshme, te shkaktuara nga veprimet arbitrare te padrejta te te paditurit. Ky nen jep perkufizimin e shkaktimit te demit dhe sipas kesaj dispozite: "Personi qe ne menyre te paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit nje dem ne personin e tij ose pasurine e tij, detyrohet te shperbleje demin e shkaktuar". Demi mund te kete karakter pasuror ose jopasuror. Neni 625, i K.Civil percakton se: "Personi qe peson nje dem te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te shperblehet kur ka pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin e personalitetin e

tij". Ky demtim i shendetit perfshin jo vetem cenimin e shendetit ne kuptimin e ngushte te tij, por edhe cenimin e te drejtave per nje jete normale private e familjare, e pa dhimbje shpirterore.

Fakti i paligjshem, kundrejt paditeses [REDACTED] solli si pasoje pakesimin e marredhenieve prinderore familjare me paditesen, te afermit familjar, si rrjedhoje edhe cenimin e interesave te ligjshme jopasurore qe lidhen me personalitetin e bashkejetuesve, si cilesia e jetes, paprekshmeria e familjes, solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirterore e tyre, etj. Demi pasuror sjell si pasoje cenimin e pasurise se te demtuarit ne kuptimin e ngushte ekonomik, pra humbjen e pasurise (deminutio patrimonii) ne menyre te paligjshme, prandaj edhe demshperblimi i demit pasuror ka per qellim te riktheje pasurine e meparshme te te demtuarit ne gjendjen e meparshme, duke "mbushur" diferencen e krijuar ndermjet gjendjes ekonomike aktuale te tij me ate te cilin do te ndodhej nese nuk vertetohej fakti i paligjshem (quanti ea res erit, tantam pecuniam condemnato).

Ne nenin 640 te K.Civil percaktohet se; "Demi pasuror qe shperblehet perbehet nga humbja e pesuar dhe fitimi i munguar. Shperblehen gjithashtu shpenzimet e kryera ne menyre te arsyeshme per te shmangur ose pakesuar demin, ato qe kane kane te nevojshme per te percaktuar pergjegjesine dhe masen e demit, si dhe shpenzimet e arsyeshme te kryera per te siguruar shperblimin ne rruge jashtegjyqesore". Ne vendimin unifikues nr.12, dt.14.09.2007, te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, ne nje ceshtje te njejte, arrihet ne perfundimin unifikues se: "Ne gjykimet me objekt detyrimet qe rrjedhin nga shkaktimi i demit, nese paditesi kerkon demshperblimin "per te gjitha demet" apo "per te gjitha demet pasurore e jopasurore", kjo menyre kerkimi perben disponimin e tij per kerkimin e demshperblimit per cdo figure te demit pasuror e jopasuror".

Ne vijim, per percaktimin e demtimeve apo cenimeve konkrete qe rrjedhin nga ky fakt i paligjshem dhe caktimin e demshperblimit perkates, duhet te vertetohet edhe lidhja shkaktesore juridike ndermjet tyre. Nepermjet lidhjes shkaktesore materiale, vertetohet se cili eshte personi pergjegjes (subjekti aktiv) dhe lidhja shkak-pasoje ndermjet tre elementeve objektive e subjektive te faktit te paligjshem (ngjarjes se demit) sjelljes se paligjshme (objektiv) e me faj (subjektiv) dhe pasojes se ardhur prej tyre, pra demtimin te nje tjetri ne personin a pasurine e tij (objektiv). Ne kete rast zbatohet parimi juridik (conditio sine qua non) sipas te cilit ardhja e pasojes se demshme nuk do te vertetohej nese nuk do te kishte ndodhur shkakun, sjellja e paligjshme dhe me faj e personit pergjegjes per shkaktimin e demit. Ndersa, me lidhjen shkaktesore juridike vertetohet lidhja shkak pasojje ndermjet faktit te paligjshem ne teresine e tij dhe cenimeve konkrete te pesuara ne te drejta dhe interesa te ligjshme, si te subjektit pasiv mbi te cilin ka vepruar direkt ky fakt i paligjshem, ashtu edhe te personave te tjere qe rezultojne te demtuar si rrjedhoje e pasojave qe pranohet se vijne normalisht e zakonisht nga i njejti fakt i paligjshem, sipas parimeve te rregullshmerise dhe eficences se lidhjes shkaktesore (id quod plerumque accidit). Ne kete kuptim, lidhja shkaktesore nuk nderpritet nese pas vertetimit te faktit te paligjshem dhe pasojes "natyrale", "materiale" te ardhur prej tij, pra demtimin apo cenimin te interesave te ligjshme te subjektit pasiv, nga sjellja e shkaktesit te demit, vijojne e vertetohen fakte te reja me pasojat e demshme, te cilat konsiderohen te lidhura e rrjedhoje direkte dhe e menjehershme e te njejtit fakt te paligjshem, perderisa provohet qe nese ky nuk ndodhte, fakti i ri i mevonshem ne vetvete nuk mund te shkaktohte edhe ai te njejten pasojje te demshme.

Ne rastin e ceshtjes objekt gjykimi, rezulton se vertetohet lidhja shkaktesore materiale ndermjet sjelljes se paligjshme e me faj te te paditurit Spitalit Rajonal Vlore dhe paditeses Urtiri Rrokaj. Lidhur me shkakun ligjor te kerkese padise ne si pale paditese mendojme se ai eshte

saktesisht i percaktuar ne nenin 608 e vijues te K.Civil dhe ne vendimin unifikues nr.12, dt.14.09.2007 te Kolegjeve te bashkuara. Ne si pale paditese mendojme se lidhur me themelin e kerkimit te objektit te kerkese padise, konflikti gjyqesor buron nga marrredhenia juridike e demshperblimit jashte kontraktor, e cila gjen rregullim ne nenin 608 e vijues te K.Civil si dhe ne rregullimet e posaçme te legjislacionit mbi demet jashtekontraktore te shkaktuara. Ky nen jep perkufizimin e shkaktimit te demit. Sipas kesaj dispozite: "Personi qe ne menyre te paligjshme dhe me faj i shkakton tjetrit nje dem ne personin ose pasurine e tij, detyrohet te shperbleje demin e shkaktuar." Neni 609, i K.Civil percakton se: "Demi duhet te jete rrjedhim i drejtperdrejt dhe i menjehershem i veprimit ose mosveprimit te personit". Nga interpretimi i dispozites se mesiperme rezulton se kater jane kushtet qe te lindi detyrimi nga shkaktimi i demit jashte kontraktor dhe konkretisht: a) te ekzistojte demi; b) ekzistenca e paligjshmerise se veprimit ose mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) lidhja shkakesore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojes (demit) te ardhur. Te kater keto kushte duhet te qendrojne bashkarisht (ne menyre kumulative) qe te ekzistojte detyrimi.

Veprimi i paligjshem ne shkaktimin e demit cilesohet nje kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetit te subjektit te se drejtes qe sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e te drejtave, lirive dhe interesave qe mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Kundraligjshmeria e sjelljes se subjektit shkaktar te demit cenon marrredheniet juridike, qe gezojne mbrojtje nga kushtetuta, aktet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, te cilat njohin dhe garantojne te drejtat e personave fizik dhe juridik ne raport me njeri-jetrin dhe pushtetin publik. Faji eshte qendrimi subjektiv i personit shkaktar te demit, ne raport me veprimin e kundraligjshem dhe pasojat qe vijne prej tij, qe nenkupton vullnetin e brendshem psikik per te kryer veprimin, per te siguruar ardhjen e pasojave ose lejimin e ardhjes se tyre. Lidhja shkakesore, vleresohet si ekzistenca e lidhjes objektive, te drejtperdrejte dhe te pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar te demit mes veprimit te kundraligjshem dhe pasojes se ardhur. Lidhja shkakesore verteton lidhjen mes tre elementeve objektiv dhe subjektiv te faktit te paligjshem, konkretisht sjelljes se paligjshme, fajit dhe pasojes se ardhur, pra demit te shkaktuar ne pasurine, shendetin ose personalitetin e subjektit te demtuar. Elementi i lidhjes shkakesore mbeshetet ne parimin (condicio sine qua non) sipas nuk te cilit nuk do te kishte ndodhur shkaku, sjellja e paligjshme dhe faji per shkaktimin e demit. Demi i cili mund te kete karakter pasuror ose jopasuror.

Neni 625 i K.Civil parashikon se: "Personi qe peson nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te shperblehet kur ka pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin e personalitetin e tij". Ne gjykimet me objekt detyrimet qe rrjedhin nga shkaktimi i demit, nese paditesi kerkon demshperblimin "per te gjitha demet" apo "per te gjitha demet pasurore e jopasurore", kjo menyre kerkimi perben disponimin e tij per kerkimin e demshperblimit per çdo figure te demit pasuror e jopasuror. Por nese kerkese padia permban kerkime per demshperblimin e figurave konkrete te demit jashtekontraktor, gjykata ka detyrimin t'i permbahet ne gjykim dhe vendim ketyre kerkimeve specifike. Ne rastin e demtimit te shendetit nga fakti i paligjshem, sikurse ka ndodhur ne çeshtjen objekt i ketij gjykimi, paditesja qe ka pesuar kete dem, ka legjitimim aktiv per kerkimin e demshperblimit te demit pasuror e jopasuror te pesuar.

Paditesja Tiftiri Rrokaj, pretendon se ka pesuar cenime te renda te shendetit e personalitetit te saj, ne marrredheniet dhe interesat familjare, si ne aspektin pasuror dhe ate jopasuror, prandaj kerkon rikthimin e gjendjes se saj te meparshme, sikur ky fakt i paligjshem te

mos kishte ndodhur, duke u detyruar i padituri t'i demshperbleje humbjet pasurore nga pakesimi i te ardhurave ne familje, si dhe demet e tjera jopasurore shendetesore per vuajtjen shpirtore, cenimin e vlerave e te cilesise se jetes familjare, personale e private te tyre.

Neni 608, i K.Civil parashikon demshperblimin per demet jashtekontraktore te pesuara nga vete i demtuari "ne personin ose ne pasurine e tij". Fakti i paligjshem, solli si pasoje pakesimin e marredhenieve prinderore familjare me paditesen, si rrjedhoje edhe cenimin e interesave te ligjshme jopasurore qe lidhen me personalitetin e tyre, si cilesia e jetes, paprekshmeria e familjes, solidariteti reciprok, dhimbja e vuajtja shpirtore e tyre, etj. Demi pasuror sjell si pasoje cenimin e pasurise se te demtuates ne kuptimin e ngushte ekonomik, pra humbjen e pasurise (deminutio patrimonii) ne menyre te paligjshme, prandaj edhe demshperblimi i demit pasuror ka per qellim te riktheje pasurine e te demtuates ne gjendjen e meparshme, duke "mbushur" diferencen e krijuar ndermjet gjendjes ekonomike aktuale te tij me ate ne te cilin do te ndodhej nese nuk vertetohej fakti i paligjshem (quanti ea res est, tantum pecuniam condemnato).

Lidhur me demin pasuror, neni 640 i K.Civil dallon humbjen e pesuar nga pakesimi i pasurise, qe njihet si demi aktual apo demi emergjent (damnum emergens) dhe fitimin e munguar (lucrum cessans). Ne parim, dallimi ndermjet demit emergjent (quantum mihi abest) dhe fitimit te munguar (quantum lucrari potuit), qendron ne aktualitetin ose jo te interesit pasuror te cenuar. Ne rastin e pare objekt i demit eshte pakesimi, humbja e nje interesi pasuror aktual, pra e nje pasurie qe i perket (in re ipsa) te demtuarit ne çastin e shkaktimit te demit. Ne rastin e fitimit te munguar kemi te bejme me pamundesine e perfitimit te nje interesi pasuror te ardhshem, pra te nje pasurie qe ende nuk i perket te demtuates ne çastin e shkaktimit te demit. Meqenese demshperblimi i kerkuar sipas nenit 643/a, te K.Civil eshte dem pasuror ne formen e fitimit te munguar, paditesja familjare ka barren e proves te vertetoje me prova pozitive mundesite konkrete efektive te kontributit ekonomik te paditeses ne te ardhmen, qe s'mund te realizohen me si rrjedhoje e faktit te paligjshem (quantum debeatur). Ne çmojme se keto jane pretendime ne funksion te percaktimit te llojit konkret te demit e te vleres se tij, sipas parimit te rregullshmerise dhe eficences shkakesore juridike. Demi biologjik i njohur ne teori si demtimi i shendetit perben ne thelb cenimin e shendetit dhe integritetit fizik e psikik te njeriut. Ky dem perben objekt kerkimi te pavarur nga demi pasuror e llojet e tjera te demit jopasuror dhe masa e demshperblimit duhet t'i perafrohet shkalles konkrete te cenimit te perheshem ose te perkohshem te integritetit fizik ose psikik te te demtuarit.

Ne kete kuptim, dispozita e nenit 625, te K.Civil ben dallimin ndermjet dy grupeve te te drejtave dhe lirive themelore te njeriut qe nuk kane natyre pasurore te mbrojtura prej saj ne rast cenimi: "demtimi i shendetit" (e drejta absolute per shendetin, ne kuptimin biologjik) dhe cenimi i "personalitetit" (teresia e te drejtave absolute te personalitetit). Nisur nga natyra specifike e te drejtave qe mbrohen, ne paragrafin "a" te nenit 625, ligjvenesi ka parashikuar se: "Personi qe peson nje dem te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te demshperblehet kur ka pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin epersonalitetin e tij..."

Demtimi i shendetit (demi biologjik) perben ne thelb, cenimin e se mires se shendetit, te integritetit fizik ose psikik te njeriut. Te drejtat e njeriut per jeten dhe shendetin jane te drejta objektive qe lindin dhe jane te padhumeshme e te pajndashme me vete ekzistencen e tij, prandaj si te tilla ato mbrohen e garantohen si te drejta themelore te njeriut nga kushtetuta (neni 3, 15/1 dhe 21 i saj). Mbrojtja e shendetit te njeriut meshirohet jo vetem ne detyrimin e shtetit per kujdesin shendetesor, por edhe ne te drejten per te realizuar kete mbrojtje ne gjykate, ndermjet te tjerave, duke detyruar cilindo qe cenon integritetin e tij fizik e psikik te demshperbleje demin e

shkaktuar. Demtimi i shendetit (demi biologjik) ky dem jopasuror i parashikuar ne shkronjen "a" te nenit 625m te K.Civil, eshte objekt kerkimi dhe demshperblimi i pavarur nga deme te tjera pasurore e jopasurore te pesuara nga i demtuari, per shkak te te njejtit fakt te paligjshem. Meqenese jeta dhe shendetit i njeriut nuk ka çmim, ne respektim te parimit themeltar kushtetues te barazise perpara ligjit dhe ndalimit te diskriminimit sipas nenit 18, te Kushtetutes, gjykata duhet te garantoje nje gjykim uniform dhe vleresim te njejte te perqindjes e te mases se demshperblimit te demit biologjik, per çdo forme e shkalle konkrete te cenimit te perhershem a te perkohshem te integritetit fizik ose psikik te te demtuarit.

Demi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) eshte shfaqje e brendshme, e perkohshme, e turbullimit te padrejte te gjendjes shpirtore te njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtor, qe rrjedh si pasoje e faktit te paligjshem. Cilido qe peson cenime ne sferen e shendetit dhe te personalitetit te tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj te nje te treti ka te drejten te kerkoje edhe demshperblimin e demit moral te pesuar. Kjo e drejte, ne cilesine e te demtuarit, i perket individualisht (ius proprius) edhe secilit prej familjareve te afert te personit, qe ka humbur jeten apo te cenuar ne shendetin e tij nga fakti i paligjshem, nese vertetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkejeteses. Demi moral i pesuar nga vete te afermit konsiderohet si pasoje, rrjedhim i menjehershem dhe i drejtperdrejte i te njejtit fakt te paligjshem.

Barra e proves per vertetimin e demit moral eshte e paditesit, por nisur nga natyra subjektive e ketij demi dhe vecçanerisht nga karakteri, shfaqja e brendshme e tij, vertetimi i cenimit te personalitetit te te demtuarit ne turbullime, dhimbje e vuajtje shpirtore, etj, nuk mund te provohet ne menyre tjeter perveçse i duke i vleresuar si te mbeshtetura ligjerisht dhe duke i çmuar si te provuara (ipso jure) me vertetimin nga paditesi te vete faktit te paligjshem dhe lidhjes se ketij fakti me cenimin moral te pesuar, sipas parimit te rregullshmerise shkakesore. Duke qene prove ne formen e prezumimit te thjeshte, nese shkaktuesi i demit nuk arrin te vertetoje te kunderten, ajo merr te njeften vlere e fuqi te plote provuese sikurse prezumimi ligjor neni 13, i K.Pr.Civile. Ne kete rast, e demtuara mund te provoje shkaktimin e demit moral me ane te prezumimit te thjeshte, sa me e afert eshte lidhja gjinore familjare apo e bashkejeteses, aq me i rende eshte edhe turbullimi e dhimbja shpirtore e te afermit te te lenuarit, pra aq me e larte eshte shuma e demshperblimit moral qe duhet t'i caktohet nga gjykata.

Ne parim, perveç prezumimit te thjeshte mbi ardhjen e pasojes morale nga afersia gjinore, per caktimin e mases se demshperblimit, ne kerkojme qe gjykata duhet te mbaje parasysh se çdo individ ka personalitetin e tij, unik dhe te ndryshem nga te tjeret, prandaj edhe shkalla e vuajtes se pasojave morale dhe masa konkrete e demshperblimit mund te ndryshoje rast pas rasti. Per kete qellim duhet qe gjykata te shqyrtojë edhe rrethana konkrete te çeshtjes per te çmuar se pari shkallen efektive te dhimbjes e vuajtes shpirtore te shkaktuar dhe ne lidhje me te, natyren e faktit te paligjshem apo rrezikshmerine e tij nese perben veper penale, shkallen e fajesise dhe ne teresi menyren e sjelljes se shkaktuesit te demit ne raport me ngjarjen dhe personat e cenuar, natyren e se drejtes se cenuar dhe te pasojave te shkaktuara nga fakti i paligjshem, kushtet subjektive te te demtuares si moshja dhe shkalla individuale e ndjeshmerise ndaj cenimit te pesuar, si dhe rrethanat qe lidhen me kushtet sociale dhe ekonomike te te demtuarit, por pa cenuar ne kete rast parimin kushtetues te barazise para ligjit dhe te ndalimit te diskriminimit te njeriut per shkak te gjendjes sociale, ekonomike, etj, ne zbatim te nenit 18/2, te Kushtetutes.

Percaktimi i mases se demit per rasin konkret nga ana e eksperteve u llogarit referuar legjislacionit ne fuqi si dhe vendimit unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte nr.12, dt.14. 09. 2007 dhe analizes se kriterete vleresuese te sipercituara. Ne kete menyre ne si pale paditese çmojme se referuar nenit 6, te K.Pr.Civile: "Gjykata qe gjykon mosmarreveshjen duhet te shprehet mbi gjithçka qe kerkohet dhe vetem per ate qe kerkohet". Nga ana tjeter neni 16/1, percakton se: "Gjykata zgjidh mosmareveshjen ne perputhje me dipsozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi, qe jane te detyrueshme te zbatohen prej saj. Ajo ben nje cilesim te sakte te fakteve dhe veprimeve qe lidhen me mosmarreveshjen, pa u lidhur me pretendimin qe mund te propozojne palet. Megjithate gjykata nuk mund te ndryshoje bazen juridike te padise pa kerkesen e pales". Ne nenin 28, te K.Pr.Civile parashikohet se: "Gjykata duhet te shprehet per te gjitha kerkesat qe parashtrohen ne padi, pa i kaluar kufijte e saj, duke realizuar nje gjykim te drejte, te pavarur dhe te paanshem brenda nje afati te arsyeshem". Ne kuptim te ketyre dispozitave, gjykata ne ushtrimin e veprimtarise se saj udhehiqet gjithnje nga ligji, nuk e paragjykon çeshtjen objekt gjykimi dhe u krijon paleve te gjitha hapesirat ligjore per te realizuar nje proces te drejte gjyqesor.

Dem ekzistencial, i shkaktuar nga fakti i paligjshem i te paditurit cenon te drejtat e personalitetit te paditeses, duke demtuar ne menyre te perhershme shprehjen dhe realizimin e te demtuarit te saj si njeri, shfaqjen e personalitetit te saj ne boten e jashtme, duke tronditur objektivisht jeten e perditshme dhe veprimtarite e zakonshme te saj, duke i shkaktuar perkeqesim te cilesise se jetes nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve te jetes, te marredhenieve personale e familiare. Demi ekzistencial, si shfaqje e jashtme e cenimit te interesave te ligjshme lidhur me cilesine e jetes, ndryshe nga ai moral eshte objektivisht i vertetueshem dhe nuk mund te provohet vetem me ane te prezumimeve te thjeshta. Gjykata duhet te pranoje vetem ato cenime konkrete te te drejtave te personalitetit, per te cilat ka bere kerkim dhe qe pretendohen nga i demtuari si dem ekzistencial i pesuar prej tij. Per caktimin e demshperblimit te demit ekzistencial, gjykata çmon mbi rrethana qe vertetojne ndryshim te dukshem e te rendesishem perkeqesues te jetes se perditshme dhe impaktin aktual e te ardhshem te ketyre ndryshimeve ne interesat jopasurore dhe marredheniet e te demtuarit me boten e jashtme.

Ne rastet e demtimit te shendetit te te afermit per caktimin e mases se demshperblimit ekzistencial mbahen parasysh edhe afersia gjinore e te demtuarit, perberja dhe gjendja e bashkejeteses ne familje, si dhe rrethana te tjera qe provojne perkeqesimin e gjendjes deri ne pamundesine e shprehjes se aftesive te te demtuarit per te zhvilluar interesat dhe veprimtarine e perditshme. Sikurse ai moral edhe demi ekzistencial ka natyre subjektive, prandaj shuma e demshperblimit te tij caktohet ne menyre te pavarur nga demi moral, por duke zbatuar te njejtat kriteret dhe metoda te vlefshme per llogaritjen e demshperblimit te ketij te fundit.

Ne caktimin e mases se demshperblimit per palet ndergjyqese, ne çmojme se duhet marre ne konsiderate moshën, shkalla e larte e nevojës se perkujdesjes nga e demtuara ne familjen e saj, prishjen e ekuilibrave familjare dhe sociale, per shkak te demit te shkaktuar, afersine gjinore te tyre me te demtuaren, tronditjen e marredhenieve familjare, veshtiresite e adoptimit ne ambientet shoqerore e sociale.

Gjykata thirri si ekspert trajtues i demeve shendetesore dhe si vleresues demi shendetesor z. [redacted] dhe si psikologe znj. [redacted]. Sic rezulton nga administrimi ne gjykim i aktit te ekspertimit i dates 12.02.2015, i hartuar nga eksperti i sipercituar, paditesja [redacted] [redacted] ka pesuar humbje te aftesise per pune, si pasojë e cenimit te aftesise fizike e psikike te saj.

ne masen 20% dhe siç rezulton nga administrimi ne gjykim i aktit te ekspertimit te hartuar nga eksperti, vlera monetare e demit eshte ne shumen totale prej 3.764.548 leke te reja”.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, pala e paditur ka prapsuar verbalisht ne seance gjyqesore, se:

“Nuk shoh asnje lloj diskriminimi qe i eshte shkaktuar nga ana jone paditeses pasi me njoftimin e dates 1779 date 23.04.2014 duke shqyrtuar kerkesat per rikthimin ne pune i eshte bere me njoftim se s’do hapet nje vend per pozicionin e saj, te azhornohet dhe te sjelle dokumentat pra nuk ka diskriminim por barazi.

Me kete prove provojme se nuk eshte e diskriminuar.

Per sa i perket objektit te padise ka nje vendim nr.2264 date 14.10.2013 te GjRr-Gj Vlore i cili ka vendosur pranimin pjeserisht te padise.

Persa i perket vendimit nr.98 date 09.10.2013 e Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi thuhet te rimerret ne pune paditesja, vendim te cili i eshte kthyer pergjigje se nuk mund te rimerrej ne pune pasi vendi ishte i zene nga nje punonjese tjeter dhe pervec kesaj ishte papershtatshmeria per ate vend pune.

Pas ketij vendimi eshte vendosur gjobe per Sptialin Rajonal per moszbatim vendimi. Kjo eshte kundershuar ne gjykate dhe eshte shfuqizuar me arsyetimin se vendimet e Komisionerit nuk jane te detyrueshme per rikthimin ne pune.

Pervec kesaj duhet nje vendim gjyqesor per deme qe i kane ardhur paditeses nga largimi nga puna.

Perfundimisht kerkojme rrezimin e padise si te pabazuar ne ligj dhe prova”.

Gjate gjykimit ne shkalle te pare, personi i trete ka prapsuar se:

“Rezultoi plotesisht e provuar se asnje prej shkaqeve te pretenduara per nderprerjen e marredhenies se punes se znj. [REDAKTUAR] ishte i bazuar. Keshtu, rezultoi se znj. [REDAKTUAR] nuk kishte munguar pa shkak te arsyeshem ne pune, pasi ka qene me raport. I pabazuar eshte edhe motivacioni i dyte, ai i mosperputhjes se arsimit me vendin e punes. Jo vetem qe perputhshmeria e arsimit me vendin e e punes vleresohet dhe vendoset ne momentin e lidhjes se kontrates se punes, por ne baze te urdhrat nr.306, dt.04.07.2012 te Ministrit te Shendetesise “Per personelin mjekesor infermier qe nuk ka plotesuar arsintin e larte”, ndalohej largimi nga puna i personelit mjekesor dhe laborant qe punon ne institucionet publike, i cili nuk ka arsimin e larte infermieror. Per me teper ky urdher i Ministrit te Shendetesise urdheron qe nese kane ndodhur largime nga puna per kete arsye, punonjesit e larguar duhet te rikthehen menjehere ne vendet e tyre te punes. Gjendja shendetesore eshte nje nga shkaqet e mbrojtura nga ligji “Per mbrojtjen nga diskriminimi”. Ne baze te nenit 3/1 te ligjit, çdo dallim, perjashtim, kufizim apo preference, bazuar ne cilindo shkak te permendur ne nenin 1 te ketij ligji, qe ka si qellim apo pasoje pengesen apo berjen e pamundur te ushtrimit ne te njejtën menyre me te tjeret, te te drejtave e lirive themelore te njohura me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, me aktet nderkombetare te ratifikuara nga Republika e Shqiperise, si dhe me ligjet ne fuqi, perben diskriminim.

Zgjidhja e kontrates se punes se ankueses, qe perben trajtimin me pak te favorshem apo pasojen negative qe ka ardhur per ankuesen, ne kushtet e ekzistences se shkakut te mbrojtur, siç eshte gjendja shendetesore dhe te mungeses se nje shpjegimi alternativ bindes nga ana e Spitalit

Rajonal Vlore e marre se bashku me qendrimet dhe veprimet kontradiktore te punedhesisit, bejne qe te gjendemi perpara nje sjelljeve diskriminuese. Ne perfundim te shqyrtimit te ankeses, Komisioneri me vendimin nr.98, dt.09.10.2013 vendosi: "Konstatimin e diskriminimit te drejtperdrejte te znj. [REDAKTUAR], per shkak te gjendjes shendetesore ne fushen e punesimit dhe rekomandoi kthimin ne vendin e punes te znj. [REDAKTUAR]".

Ne baze te ligjit "Per mbrojtjen nga diskriminimi", subjektet e gjetur ne shkelje te ligjit kane detyrimin qe brenda 30 diteve te informojne Komisionerin lidhur me zbatimin e vendimit. Me shkresen nr. 2724 prot, dt.22.10.2013, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore, nuk informon Komisionerin lidhur me masat qe ka marre per zbatimin e vendimit per rikthimin ne pune te ankuases, por kerkon qe Komisioneri te marre ne konsiderate edhe njehere vendimin nr.98, dt.09.10.2013. Ne vijim, Komisioneri me shkresen nr.549 prot, dt.30.10.2013, ka informuar se ai nuk ka te drejten e revokimit te vendimit, duke i rikujtuar detyrimin ligjor per zbatimin e vendimit brenda afateve ligjore. Me shkresen nr.2838 prot, dt.01.11.2013, Spitali Rajonal Vlore ka informuar Komisionerin se: "Nuk mund te ndermarrin asnje veprim dhe vendim per rikthimin e znj. Tiftiri Rrokaj ne marredheniet e meparshme te punes, pasi ne zbatim te urdhrimit te Ministrit te Shendetesise nr.506 prot, dt.18.09.2013 "Per ndalimin e procedurave te marrjes dhe largimit nga puna, te punonjesve dhe dhenien me qira te ambienteve dhe hapësirave, ne institucionet shendetesore", pezullohen deri ne nje urdher te dyte procedurat e marrjes dhe largimit nga puna, te punonjesve ne institucionet shendetesore". Me shkresen nr.318 prot, dt.18.03.2014, Komisioneri i ka kerkuar Spitalit Rajonal Vlore, informacion mbi zbatimin e vendimit nr.98, dt.09.10.2013. Ne pergjigje te kesaj kerkese, me shkresen nr.1338 prot, dt.21.03.2014, Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore, informon Komisionerin se: "E kane te pamundur te zbatojne rekomandimin pasi per ne baze te vendimit nr.2264, dt.14.10.2013 te Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Vlore, per pretendimin e znj. [REDAKTUAR] per rikthimin ne vendin e meparshem te punes, gjykata ka çmuar se ai duhet te rrezohet. Nga permbajtja e vendimit nr.2264, dt.24.10.2013 te Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Vlore, nuk rezulton qe kjo gjykate te kete shqyrtuar pretendimin per diskriminim te paditeses e ne perfundim te kete vendosur per rrezimin e kerkeses se saj per rikthim ne vendin e punes.

Pala paditese me shkresen nr.2838 prot, dt.01.11.2013 me ane te se ciles njofton Komisionerin se nuk mund ta zbatoje vendimin per rikthimin ne pune te ankuases e konsideron si pengese urdhrin nr.506, dt.18.09.2013 te Ministrit te Shendetesise "Per ndalimin e procedurave te marrjes dhe largimit nga puna, te punonjesve dhe dhenien me qira te ambienteve dhe hapësirave, ne institucionet shendetesore", nderkohe qe nuk ka qene aspak pengese per ate, zgjidhja e kontrates se punes me znj. Rrokaj, edhe pse ne baze te nje urdhri tjeter te Ministrit te Shendetesise nr.306, dt.04.07.2012 "Per personelin mjekesor infermier qe nuk ka plotesuar arsimin e larte", ndalohej largimi nga puna i personelit mjekesor dhe laborant qe punon ne institucionet publike, i cili nuk kishte arsimin e larte.

Me shkresen nr.1779 prot, dt.23.04.2014 Spitali Rajonal Vlore ka njoftuar znj. [REDAKTUAR] se vendi i laborantes ne laboratorin bio-kimik ne poliklinike eshte plotesuar. Urdhri nr.506, dt.18.09.2013 i Ministrit te Shendetesise "Per ndalimin e procedurave te marrjes dhe largimit nga puna, te punonjesve dhe dhenien me qira te ambienteve dhe hapësirave, ne institucionet shendetesore", te cilit i eshte referuar pala paditese per te mos zbatuar vendimin e Komisionerit, nuk e ka penguar ate qe te marre ne pune personel te ri.

Sa me sipër dhe bazuar në nenin 33/11, të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" me vendimin nr.56, dt.17.04.2014, Komisioneri ka gjobitur Spitalin Rajonal Vlorë me 60.000 (gjashtëdhjetë) mijë leke.

Theksojmë se vendimi nr.98, dt.09.10.2013, i cili ka konstatuar diskriminimin e [REDAKTUAR] është një akt i cili nuk është kundërshtuar gjyqësisht nga ana e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë. Në bazë të nenit 37, të ligjit nr.10 221, dt.04.02.2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se: "1.Vendimi i gjykates cakton demshperblim nese gjykata vendos qe ka shkelje te ketij ligji, duke perfshire edhe nje afat kohor per kryerjen e zhdemimit. 3.Vendosja e masave, sipas ketij ligji, nuk perjashton vendosjen e masave sipas ligjeve te tjera". Sa me sipër, KMD ashtu siç ka konstatuar edhe me vendimin nr.98, dt.09.10.2013, vlerëson se ndodhemi në kushtet që pala e paditur ka shkelur dispozitat e ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe për rrjedhojë gjykata duhet të caktojë një demshperblim për palën paditese.

Bazuar në nenin 38, të ligjit nr.10 221, dt.04.02.2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", ku parashikohet se: "Demshperblimi perfshin, nder te tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe te pasojave te tyre permes kthimit ne gjendjen e meparshme, kompensimin e duhur per demet pasurore si dhe jopasurore, ose permes masave te tjera te pershtatshme".

Në analizë të dispozitave të Kodit Civil për pergjegjesinë për rastet e shkaktimeve të demit dhe konkretisht nënëve 608, 609, 625 dhe 640, të Kodit Civil rezulton se duhet të plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte që të lindë detyrimi për shkaktimeve të demit jashtë kontraktor. Konkretisht, të ekzistojë demit, ekzistenca e paligjshmerisë së veprimit ose mosveprimit, ekzistenca e fajit, lidhja shkaksore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (demit) të ardhur. Në rastin e çështjes objekt gjykimi rezulton plotësisht e provuar ekzistenca e këtyre kushteve të mesipër, ekziston demit sipas raporteve të vlerësimit nga ekspertet përkatës, rezultojnë plotësisht të provuara veprimet në kundërshtim me ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të konsumuara nga ana e palës paditese, veprime këto të kryera me faj prej palës paditese dhe ekziston lidhja e drejtperdrejte midis veprimeve të paligjshme dhe demit që i ka ardhur paditese.

Po ashtu në bazë të vendimit unifikues nr.12, dt.14.09.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjyqesës së Lartë, është arritur në përfundim unifikues se: "Në gjykimet me objekt detyrimet që rrjedhin nga shkaktimeve të demit, nëse paditësi kërkon demshperblimin "për të gjitha demet" apo "për të gjitha demet pasurore e jopasurore", kjo mënyrë kerkimi përben disponimin e tij për kerkimin e demshperblimit për çdo figurë të demit pasuror e jopasuror."

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me Vendimin Nr.714 Dt.10.04.2015, ka vendosur rrezimin e kërkespadiës, duke argumentuar se:

"Gjykata çmon të theksojë se në rastet e paditësive të tilla, që kanë për qëllim shperblimin e demit të shkaktimeve nga një fakt i paligjshëm duhet të provohet në mënyrë të pakundërshtueshme, përveç ekzistencës së faktit të paligjshëm nga njëra anë dhe demit të shkaktimeve të tjerë edhe lidhja shkaksore midis tyre, në mënyrë që të jete e qarte për gjykatën se demit është rrjedhojë e drejtperdrejte e menjehershme dhe e parashikueshme e faktit të paligjshëm.

Të analizuar me radhë në bazë të provave të paraqitura, gjykata konstatoi se nuk u provua në këtë gjykim asnjë nga elementet e mesipër.

Përsa i përket faktit të paligjshëm të pretenduar "urdhri i Spitalit Rajonal Vlorë për largimin nga puna", çmohet se me kërkesë të paditësit ky urdher është shfuqizuar me anë të

vendimit nr.2264, dt.14.10.2013 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, e cila ka vendosur te detyroje palen e paditur Spitalit Rajonal Vlore, te demshpebleje paditesen [REDAKTUAR] per largim te padrejte nga puna. Ky vendim eshte i formes se prere dhe i detyrueshem per palet. Ne kete menyre, fakti i pretenduar si i paligjshem nuk ekziston pas dt.19.11.2013, date ne te cilen vendimi ka marre forme te prere.

Persa i perket demit te shkaktuar, paditesja pretendoi se humbja e punes eshte konceptuar nga ai si nje ngjarje e rende qe ka lene pasoja, duke i shkaktuar turbullime ne jeten shpirtore dhe shendetesore. Gjate ketij gjykimi nuk u paraqit asnje prove per te provuar demin qe i eshte shkaktuar paditeses dhe familjareve te saj. Megjithate paditesi per te provuar demin jopasuror (shendetesor, cenim te personaliteti dhe te nderit) kerkoj marrjen e proves me ekspert psikolog. Nga akti i ekspertimit rezultoi se paditesi shfaq simptoma te depresionit dhe te ankthit, qe jane zhvilluar ne kohën pas shkarkimit nga detyra, gjendje e cila ka ndikuar ne realizimin e potencialit te vet njerezor, profesional, qe ka ndikuar ne mospunesimin e tij. I pyetur gjate relatimit te aktit, ne lidhje me simptomat e depresionit dhe te ankthit, ekspertja pranoi se rezultatet e mesiperme ishin nxjerre ne baze te raportimit te subjektit te intervistuar. Nuk rezultoi qe psikologu t'i ishte referuar ndonje karteles mjeksore, pershkrimi te meparshem psikologjik - klinik, apo trajtimit me medikamente.

Ne kete menyre gjykata arrin ne konkluzionin se, gjendja emocionale e paditeses nuk shfaqet e cenuar apo e lekundur ne permasat qe mund te konsiderohet e demtuar. Rrjedhimisht nuk çmohet se tek paditesja verehet dem personal i tille, qe ta legjitimoje ate te kerkoje shperblim monetar sipas nenit 625, te Kodit Civil.

Gjykata çmon te theksoje se tronditja emocionale per shkak te largimit nga puna eshte rrjedhim i zakonshem i zhvillimit te faktit dhe ne kete menyre prezumohet pa qene e nevojshme prova me ekspert, qe shkarkimi nga detyra ka shkaktuar te paditesja [REDAKTUAR] zhgenjim, merzitje dhe emocione negative, dhe pse jo dhe tronditje te besimit ne mirefunksionimin e institucioneve shqiptare.

Megjithate çmohet se keto pasoja jane rrjedhim i zakonshem i situatave te filla qe mund te ndodhin tek çdo person, qe ne menyre te padrejte largohet nga puna. Gjithashtu eshte fakt i njohur boterisht qe ne shoqerine tone situata te filla nuk jane te rralla dhe largimi nga puna jo detyrimisht krijon pershtypjen tek te tjeret, se kjo ka ndodhur per shkak te paaftesise profesionale apo mungeses se cilesive personale.

Neni 625/a, i Kodit Civil parashikon: "Personi qe peson nje dem, te ndryshem nga ai pasuror, ka te drejte te kerkoje te shperblehet kur: 1. Ka pesuar nje demtim te shendetit ose eshte cenuar ne nderin e personalitetit te tij".

Persa i perket shendetit mendor i pretenduar si i demtuar ne sferen e afeksionit, gjykata çmon se ne rast se ky demtim do te ekzistonte ne permasat per te cilat lind e nevojshme kerkimi i demshperblimit, paditesja do t'i ishte nenshtuar trajtimit psikologjik apo mjekesor, gje qe nuk u provua ne kete gjykim. Persa i perket cenimit te nderit dhe personalitetit vlen fillimisht te sqarohet kuptimi literal i tyre per shkak te abstragimit qe permbajne ne vetvete dy nocionet e mesiperme. Ne baze te "Fjalorit te shqipes se sotme", botim i vitit 1984, fjala "nder", ka kuptimin e "teresive te vetive a tipareve morale te njeriut, qe burojne nga parime te caktuara qe çmohen nga shoqeria dhe qe shfaqen ne sjelljet dhe ne veprimet e tij ne rruge te drejte" ose "emer i mire qe gezon dikush para te tjereve". Çmohet se eshte kuptimi i dyte i ketij termi qe i pergjigjet rastit te nenit te cituar: "Emri i mire qe gezon dikush para te tjereve". Ndersa fjala

“personalitet”, po sipas ketij fjalori ka kuptimin e teresise se veçorive psikike, te karakterit, te sjelljes, te veprimtarise se njeriut, te cilat e dallojne ate nga te tjeret.

Gjykata çmon se urdhri i largimit nga puna ne te cilin nuk gjendet i artikuluar ndonje motivacion fyes, shpifes, denigrues, diskriminues etj, nuk eshte rasti qe ndikon ne cenimin e nderit apo te personalitetit te personit. Megjithate siç u theksua edhe me lart, largimi padrejtesisht nga puna, shkakton ne menyre te logjikshme vuajtje shpirtore dhe tronditje emocionale, por ato vleresohet se jane te permasave te çdo vuajtje apo tronditje, qe nje njeri normal perjeton kur gjendet perpara nje padrejtesie te ushtruar nga eprori apo punedhënesi. Kjo eshte edhe arsyeja qe Kodi i Punes ka parashikuar demshperblimin per largimin nga puna pa shkak te arsyeshem ne nenin 146 ose per largimin nga puna pa shkaqe te justifikuarca ne nenin 155 te tij, deri ne 12 paga mujore per secilin rast.

Si rrjedhim, gjykata çmon se largimi ne menyre te padrejte nga puna nuk eshte shkak per te kerkuar demshperblim pertej atyre qe parashikon Kodi i Punes.

Persa i perket lidhjes shkakësore mes faktit te paligjshem dhe pasojes, gjykata çmoi se edhe ky element teper i rendesishem i ketij gjykimi, nuk u arrit te provohej nga pala paditese. Edhe ne rast se do te rezultonin te provuar dy elementet e pare, nuk u provua rrjedhimi i drejtperdrejte dhe i menjehershem i pasojes per shkak te faktit te paligjshem. E vetmja prove ne te cilin u mbeshitet paditesi per kete rast ishte raporti i eksperteve. Nga ana tjeter çmohet te theksohet se shkak per shfaqjen e simptomave te ankthit dhe te depresionit mund te jene edhe faktore te tjere te pranishem me te cilat njeriu ndeshet ne perditeshmerine e tij, faktore te cilet nuk mund te perjashtohet se ndikojne tek individi.

Ne lidhje me demin pasuror te pretenduar, gjykata çmon te theksoje se perderisa ekziston nje vendim gjyqesor i cili eshte shprehur per vazhdimin e pageses se paditesit, konsiderohet se ky dem nuk ekziston. Vlen te sqarohet si pika e fundit e ketij arsyetimi edhe fakti nese largimi i padrejte nga puna perben shkak per ngritjen e padise se konsideruar si padia aquiliana. Çmohet ne vazhdim te arsyetimit te mesiperme se shkak qe mund t'i vendose dy palet e ketij gjykimi ne nje marredhenie detyrimi, nuk eshte fakti i paligjshem, por marredhenia kontraktore e punes, nga e cila ka rrjedhur dhe fakti “urdhri i largimit”, i cili megjithese i paligjshem eshte rrjedhoje e kesaj marredhenie. Ne padine aquiliana, ajo qe i vendos palet ne marredhenie detyrimi eshte ndodhja e faktit, psh, aksidenti automobilistik nga i cili humb jeten ose demton shendetin nje person, ose shkaktimi i nje zjarri nga i cili demtohet pasuria e nje individi.

Ne rastin konkret fakti ka ndodhur per shkak te marredhenies juridike mes paleve. Fakti nuk do te kishte ndodhur nese paditesja Tiftiri Rrokaj dhe Spitali Rajonal Vlore nuk do te ishin ne marredhenie juridike ndermjet tyre, nderkohe qe ne rastin e padise per shperblimin e demit eshte fakti qe ndodh, shkak qe palet vendosen ne marredhenie detyrimi dhe vetem ne kete rast çeshtja trajtohet sipas “lex aquilia de damno”.

Si rrjedhim gjykata çmon se per te gjitha arsyet e parashtruara me siper kjo padi duhet te rrezohet si e pambeshtetur ne prova e ne ligj”.

Vleresimi i Gjykates se Apelit Administrativ.

Gjykata e Apelit Administrativ venen se, vendimi objekt ankimi eshte disponim nga ana e nje gjykate jokompetente, me pasoje zhvillimin e nje procesi te parregullt gjyqesor.

Ne Nenin 42/2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, parashikohet se:

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Gjykata Kushtetuese, lidhur me procesin e rregullt ligjor, në Vendimin Nr.11 Dt.23.04.2009, shprehet se:

“Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuader, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështje të caktuar”.

Presidenti i Republikës, me Dekretin Nr.8349 Dt.14.10.2013, ka përcaktuar datën 04.11.2013, si datë të fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

Veprimtaria e gjykatave administrative, rregullohet me Ligjin Nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në Nenin 72/2 të cilit parashikohet se:

“Sa here që në ligje të posaçme behet referim në seksionet administrative apo në kreun “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative” të Kodit të Procedurës Civile apo në gjykatën kompetente, referenca vlerësohet si e here në këtë ligj dhe në gjykatën administrative kompetente, sipas këtij ligji”.

Gjykatat administrative filluan të funksionojnë me datë 4 Nëntor 2013 dhe që nga kjo datë, në kuptim të përmbajtjes së dispozitës së mesipërme, mosmarrëveshjet administrative janë kompetencë lëndore e gjykatave administrative.

Ky qëndrim është diktuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të cilët, me Vendimin Unifikues Nr.3 Dt.06.12.2013, kanë unifikuar praktiken gjyqësore, duke konkluduar se:

“Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me Ligjin nr.49, datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi, ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma”.

Gjykata e Apelit Administrativ tërheq vëmendjen mbi faktin se, çështja e kompetencës lëndore të gjykatave administrative, rregullohet shprehimisht në Nenin 7 të Ligjit Nr.49/2012, dispozite që, sipas përmbajtjes së të cilit:

"Kompetenca lëndore.

Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet rënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik".

Me tej Neni 17 parashikon se:

"1. Padia ngrihet:

f) për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, sipas ligjit të posaçëm".

Referuar te dhenave te dosjes qe i perket vendimit objekt ankimi, rezulton qe ai te jete shpalluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, me date 10.04.2015.

Objekti i kesaj mosmarreveshje konsiston ne shperblimin e demit jopasuror, shkaktuar nga largimi i padrejte nga puna.

Gjykata e Apelit Vlore, nepermjet Vendimir Nr.1317 Dt.19.11.2015, ka shpallur moskompetencen per gjykimin e ceshtjes dhe dergimin e akteve Gjykates se Apelit Administrativ, duke argumentuar se:

"Se pari: Me ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dh gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", është përcaktuar si krijimi i këtyre gjykatave te veçanta, ashtu edhe rregullat për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Nder të tjera, në nenin 1, shkronja "b" të këtij ligji, parashikohet se ai percakton edhe rregullat per juridiksionin dhe kompetencen e gjykatave administrative. Referuar neneve 4 dhe 7 të ligjit për gjykatat administrative, konstatohet se mosmarreveshja, hyn në juridiksionin e tyre dhe se janë këto gjykata, të cilave ligji u ka dhënë kompetencen për të gjykuar mosmarrëveshjet administrative, siç është edhe ajo e rastit në shqyrtim. Ashtu sikurse arsyeton edhe gjykata e shkallës së parë, paditësja ne padi dhe ne kerkimet e saj ka kërkuar shpërblimin e dëmit moral dhe material të shkaktuar nga një Institucion Shtetëror, konkretisht nga vendimi i Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlore, me anë të të cilit paditësja është pushuar nga puna. Nisur edhe nga sa parashtruar me siper dëmshepërblimi rezulton se në thelb të kërtimeve të paditësit qëndron demshepërblimi per nje dem për një të shkaktuar nga një Organ i Administratës Shtetërore, kompetente për shqyrtimin e së cilës janë Gjykatat Administrative.

Nga sa më sipër rezulton se padia objekt gjykimi ka dy kërtime: (i) shpërblimin për dëmin moral dhe material dhe fitimin e munguar; dhe, (ii) rivendosje në afat të së drejtës së cënuar nga veprimet e një Organi të Administratës Shtetërore. Kjo gjykatë çmon se për përcaktimin e drejtë të kompetencës lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, është e rëndësishme të sqarohet dhe kuptohet natyra juridike dhe shkak ligjor i mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse. Kështu nga leximi i padisë së paditëses dhe ndërhyrësave dytësore, rezulton se këta të fund nder te tjera kanë pretenduar se: "Nga ana e palës së paditur është bërë një diskriminim i cili ka sjellë shkaktimin e një dëmi moral dhe material. Ky diskriminim ka ardhur për shkak të pushimit nga puna në mënyrë të kundërligjshme, fakt ky qe eshte konstatuar edhe nga personi i tretë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Pra, nga leximi i padisë së paditëses [REDACTED] rezulton se në thelb të

kërkimeve të saj qëndron shpërblimi i një dëmi të shkaktuar nga një Organ i Administratës Shtetërore. Nga aktet që ndodhen në dosje, rezulton qartë që konflikti dhe mosmarrëveshja mes palëve ka lindur si pasojë e pushimit nga puna të paditeses nga pala e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë. Pikërisht, përcaktimi i natyrës së aktit që kundërshtohet në procesin gjyqësor, dikton dhe gjykatën që duhet të ushtrojë kontrollin gjyqësor, e cila në rastin në shqyrtim duhet të jetë Gjykata Administrative. Këto gjykata janë krijuar si organe të specializuara për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, dhe në referim të nenit 7 pika a) të Ligjit nr.49/2012, në kompetencën lëndore të tyre ndër të tjera, përfshihen "mosmarrëveshje që lindin për aktet administrative individuale, akte nënligjore normative dhe kontratat administrative publike të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të organe publike".

Se dyti: Gjykatat administrative filluan funksionimin e tyre në datë 4 Nëntor 2013 dhe që nga kjo datë, mosmarrëveshjet administrative, janë në kompetencë administrative. Sa i përket çështjes së veprimit në kohë të ligjit, rezulton se në dispozitat tranzitore, ligjvënësi nuk ka bërë asnjë parashikim lidhur me vijimin e gjykimit për çështjet tashmë të filluara. Një situatë e tillë është rregulluar nga vendimi unifikues nr.3, datë 06.12.2013 i Gjykates së Lartë, i cili ka unifikuar raktiken gjyqësore duke përcaktuar ndër të tjera edhe fatin e çështjeve të paraqitura në Gjykatat e Apelit mbi ankimin e palëve në proces. Në paragrafin 19 të këtij vendimi është parashikuar shprehimisht: Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në interpretimin unifikues se: Gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë krijuara me ligjin nr.49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit. Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat, padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë, shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma."

Në këto rrethana, Gjykata e Apelit, në përmbushje të detyrimit për të verifikuar kompetencën edhe kryesisht, konstatoi se ajo nuk është më kompetente për gjykimin e çështjes, pasi ligji ngarkon për këtë gjykatat administrative".

Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, Gjykata e Apelit Vlore, duke çmuar me të drejtë se kjo çështje, nga pikepamja e kompetencës lëndore i perkiste gjykatave administrative, me vendimin e saj Dt.19.11.2015, disponuar pas vendimit unifikues me të dhenat e sipërcituara, në vend të shpalljes së moskompetencës lëndore, do të duhej që, për të njejtat shkaqe të evidentuara në vendimin e saj, të kishte prishur vendimin e shkallës së parë, duke urdheruar njëherësh kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën administrative kompetente të shkallës së parë.

Neni 50/ç i Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, parashikon se:

"Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos: ...

ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit".

Ne kushtet kur Ligji Nr.49/2012, nuk parashikon shprehimisht rastet qe diktojne prishjen e vendimit ne dhome keshillimi, lipset t'i referohemi Nenin 1/2, sipas permbajtjes se te cilit:

“Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”.

Konkretisht, Neni 467/a i K.Pr.Civile, i ndryshuar, parashikon se:

“ Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushtjeve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur:

a) gjykata e shkallës së parë ka shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe kompetencën”.

Gjykata e Apelit Administrativ verën se, Kodi i Procedures Civile ka pesuar ndryshime nepermjet Ligjit Nr.38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, ne Nenin 109 te te cilit, parashikohet se:

“1. Çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë”.

Gjykata e Apelit Administrativ verën gjithashtu se, ne kohen paraqitjes ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlore, te kerkespadise se paditeses [REDACTED] Neni 467/a i K.Pr.Civile, kishte permbajtjen e cituar me lart.

Perfundimisht gjykata çmon se ndodhet ne rrethanat e parashikuara ne dispozitat e mesiperme procedurale.

Sa me siper konfirmohet edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykeses se Larte i cili, nepermjet Vendimit Nr.00-2018-720 Dt.05.06.2018, ka arsyetuar dhe konkluduar se:

“Vendimi Nr.82 (62-2018-301), datë 25.01.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, që ka shpallur moskompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes, duke i dërguar aktet për vazhdimin e gjykimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe për këtë shkak ai duhet të priset dhe çështja duhet të dërgohet në po këtë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.

Kolegji Administrativ e gjen me vend të rikonfirmojë qëndrimin se kompetenca e gjykatës nga pikëpamja lëndore për gjykimin e një mosmarrëveshje është shumë e rëndësishme si element që garanton procesin e rregullt ligjor. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural.

Kolegji Administrativ në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes nëse është e natyrës civile apo administrative. Kolegji e vlerëson të gabuar arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata nuk ka përcaktuar drejtë natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe qëllimin e vërtetë të këtij gjykimi

duke mos bërë një identifikim të elementeve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në arsyetimin e vendimit thekson faktin se në zbatim të ligjit nr.49/2012 çështja objekt gjykimi referuar përmbajtjes së kërkesë padisë dhe akteve që e shoqërojnë, meqenëse një nga palët është organi i administratës publike dhe pala paditëse pretendon se ky organ i ka shkaktuar dëm jashtëkontraktor gjatë ushtrimit të kompetencave të veta. Ndonëse një palët është person juridik privatë, në kushtet kur pala paditëse e ka paraqitur padinë duke ja kundrejtuar kërkimin e tij të dy palëve të paditura në mënyrë solidare, nuk mund të procedohet me veçimin e kërtimeve të çështjes.

Nga kërkesë padia rezulton se kërkitimi i paditëses në këtë gjykim është : “Detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer paditësin për dëmin e pësuar në pasurinë me nr.194/1 si dhe fitimin e munguar për mospërdorimin e kësaj prone”, bazuar në nenin K.Pr.Civile dhe K.Civil.

Referuar objektit të padisë jemi në kushtet kur asnjë nga Gjykatat, si ajo e shkallë së parë Fier dhe ajo administrative Vlorë nuk kanë kompetencë lëndore në shqyrtimin e të gjithë objektit të kërkesë padisë, pasi jemi në kushte kur janë paditur dy persona juridik të ndryshme pra një shoqëri tregtare dhe një organ publik.

Kolegji çmon se duke vlerësuar shkaku ligjor të kërimit ndodhemi përpara një gjykimi që përbën mosmarrëveshje me natyrë të përzier, e cila rregullohet si nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, po ashtu edhe nga ligji nr.49/2012 “për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky fakt rezulton nga kërkitimet e vetë paditësit i cili pretendon se është cënuar në të drejtat e tij dhe kërkon nga gjykata të përcaktojë se kush është subjekti që me veprimet e tij ka sjell pasojë në dëm të tij.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është kompetente për gjykimin në shkallë të parë vetëm për ato çështje të përcaktuara nga K.Pr.Civile dhe konkretisht është kompetente në lidhje me gjykimin e palës së paditur Bankers Petrolum Albania LTD, ndërsa Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është kompetente për shqyrtimin në lidhje me Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, prandaj gjykata e shkallës së parë Fier duhej të kishte veçuar çështjen dhe të vazhdonte gjykimin sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara për gjykimin në shkallë të parë.

Në çdo rast, ky Kolegj thekson edhe njëherë, se moskompetenca për zgjidhjen e çështjes përbën shkelje të rëndë procedurale, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në dhënien e vendimit në kuptimin që, mosrespektimi i kompetencës e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm. Prandaj në çështjen objekt gjykimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier do të duhej të veçonte çështjen për ato pika të objektit të padisë apo të paditur për të cilën ajo nuk është kompetente për shqyrtimin e tyre, duke ja dërguar gjykatës kompetente, si dhe të shqyrtonte ato për të cilat është kompetente.

Ky Kolegj, në referim të analizës së sipërcituar vlerëson se çështja konkrete përbën një mosmarrëveshje me natyrë të përzier si civile dhe administrative dhe bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e çështjes për të paditurin Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier dhe jo për shoqërinë Bankers Petrolum Albania LTD”.

Ne funksion te identifikimit te gjykates administrative kompetente nga pikepamja tokesore, per shqyrtimin e ketij konflikti, Gjykata e Apelit Administrativ çmon te nevojshme te sqaroje se, Neni 11 i Ligjit Nr.49/2012, parashikon se:

“1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.

2. Paditë për marrëdhëniet e punësimit shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij.

3. Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij.

4. Paditë për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, përveç sa është parashikuar në këtë ligj, shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin ku paditësi ka banimin ose vendqëndrimin.

5. Kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur”.

Gjykata e Apelit Administrativ verën se, në kushtet kur konflikti i percjelle nga Gjykata e Apelit Shkoder, nuk gjen rregullim në dispozitën e sipercituar, lipset t'i referohemi dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, me rol plotësues në këtë rast, çka diktohet nga Neni 1/2 i Ligjit Nr.49/2012 (cituar me lart).

Konkretisht, Neni 42/1 i K.Pr.Civile, parashikon se:

“Paditë ngrihen në gjykatën e vendit ku i padituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe kur këto nuk dihen, në gjykatën e vendit ku ai ka banesën e përkohshme”.

Me tej Neni 48 parashikon se:

“Paditë që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu dhe në gjykatën e vendit ku është shkaktuar dëmi”.

Gjykata e Apelit Administrativ verën se, Dekreti Nr.7818 Dt.16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, parashikon në Piken 5/4 se:

“Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykatat administrative organizohen në 6 gjykata të shkallës së parë dhe 1 gjykatë apeli. 6 gjykatat administrative të shkallës së parë kanë kompetencë tokësore dhe seli qendrore të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë: ...

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka kompetencë tokësore në rrethet: Berat, Skrapar, Kuçovë, Fier, Mallakastër, Lushnjë dhe Vlorë me seli qendrore në Vlorë.”.

Per sa me siper, kompetente nga pikepamja lendore e tokesore per shqyrtimin e padise me objekt shperblimin e demit rezulton Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, persa kohe i padituri e ka seline ne qytetin e Vlores, vend ku eshte shkaktuar edhe demi i kerkuar me padi.

Shpenzime gjyqesore lidhur me kete çeshtje, ne Gjykatën e Apelit Administrativ, nuk u kryen.

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne Nenin 50/ç te Ligjit Nr.49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar, unanimisht:

VENDOSI

- Prishjen e Vendimit Nr.714 Dt.10.04.2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore dhe kthimin e çeshtjes per rigjykim, ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Vlore;
- Shpenzime gjyqesore ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen;
- E drejta e rekursit kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ne Gjykatën e Larte brenda 30 diteve, duke filluar nga e nesermja e komunikimit te tij paleve ndergjyqese.

U shpall sot ne Tirane, me 31 te Janarit 2019.

ANETAR
Arjan QAFA
dv

ANETARE
Fjoralba PRIFTI
dv

KRYESUESE
Blcrona HASA
dv

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari
Lindorë Stevriq
